



REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR			
MINISTARSTVO ZHIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA			
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANING			
Njësia Org. Org.Jednica Org.Unit	M-01	Nr.Prot. Broj.Prot. Prot.No	1349/26
Nr. i faqeve Broj.stranica No.pages	02	Data Datum Date	24.03.26
PRISHTINË/A			

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Zivotne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment, Spatial and Planning

Nr.5/2026
Data 24/03/2026

Ministrja e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në mbështetje të nenit 93 paragrafit 4 të Kushtetutës së Kosovës, në përputhje me nenin 11 nënparagrafi 1.5 i Ligjit Nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.34/2022), të nenit 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 Për Organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.7/2019), nenin 17 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 i Rregullores Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, në mbështetje të nenit 6 paragrafi 2, nenit 8, 9, 10, 31, 34 dhe 81 të Ligjit nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 50/2009), në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe të Ligjit Nr.03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 85/2010), në përputhje me Udhëzimin Administrativ (MMPHI) Nr.04/2022 për Leje Mjedisore i ndryshuar dhe plotësuar, në pajtim me kompetencat e përcaktuara në Ligjin Nr. 04/L-175 për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit (Gazeta Zyrtare Nr. 43/2013), nxjerr këtë:

V E N D I M

1. **OBLIGOHEN** në mënyrë të prerë dhe të menjëhershme të gjithë operatorët ekonomikë që ushtrojnë veprimtari minerare të gurëthyesve në territorin e Republikës së Kosovës, që t'i nënshtrohen procesit të verifikimit të plotë të pajtueshmërisë ligjore, teknike dhe mjedisore.
2. Me qëllim të verifikimit të plotë të pajtueshmërisë ligjore, teknike dhe mjedisore, obligohen të gjithë operatorët ekonomikë që ushtrojnë veprimtarinë e gurëthyesit në territorin e Republikës së Kosovës që të dorëzojnë pranë Departamentit për Mbrojtjen e Mjedisit, dokumentacionin e plotë si: lejen mjedisore të vlefshme, pëlqimin mjedisor, planin e menaxhimit dhe rehabilitimit mjedisor, dokumentacion tjetër përkatës që dëshmon respektimin e kushteve mjedisore, si dhe të gjitha licencat nga organet kompetente për ushtrimin e veprimtarisë së gurëthyesit, gjejgësisht dosjen e plotë me dokumentacionin percjellës.

Dosja e dorëzuar nga secili operator duhet të përfshijë detyrimisht rilevim gjeodezik të përditësuar, që pasqyron saktë gjendjen aktuale të terrenit dhe vëllimin e materialit të shfrytëzuar.

3. **AFATI** për dorëzimin e dosjes së plotë me dokumentacionin përcjellës është pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
Ky afat është përfundimtar (prekluziv). Asnjë kërkesë për zgjatje, shtyrje apo arsyetim për vonesë nuk do të merret në konsideratë.
4. **MOSDORËZIMI** i dokumentacionit brenda afatit të përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, rezulton në humbjen e të drejtës për shqyrtim administrativ dhe aktivizon inspektimin e jashtëzakonshëm të menjëhershëm në terren. Ky inspektim do të kryhet pa asnjë paralajmërim paraprak dhe do të shërbejë si bazë direkte për marrjen e masave sipas ligjit në fuqi.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Departamentit për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Inspektorati i Mbrojtjes së Mjedisit.
6. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Ministria, në ushtrim të kompetencave të saj ligjore për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe veprimtarive minerare, ka vlerësuar se është e nevojshme të verifikohet pajtueshmëria ligjore dhe mjedisore e operatorëve të gurëthyesve. Duke qenë se kjo veprimtari ndikon drejtpërdrejt në mjedis dhe burime natyrore, kërkesa për dorëzimin e dokumentacionit përkatës është masë e ligjshme, e arsyeshme dhe në funksion të mbrojtjes së interesit publik, si pasojë është vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- Të gjithë operatorëve ekonomikë që ushtrojnë veprimtari minerare të gurëthyesve,
- Kabinetit të Ministres të MMPH-se;
- Sekretari i Përgjithshëm;
- Departamentit për Mbrojtjen e Mjedisit;
- Inspektorati i Ministrisë;
- Divizioni për Komunikim Publik;
- Arkivi i MMPH-së.

